



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE “POSTA E
KOSOVËS “**
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të NP Posta e Kosovës Sh.A., në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit të auditimit Jusuf Kryeziu dhe anëtarëve të ekipit Alban Shatri, Aida Podrimaj dhe Naim Neziri, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Fitim Haliti.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme..... | 4 |
| 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 7 |
| 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 8 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 22 |
| 4 Qeverisja e mirë..... | 33 |
| 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 37 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA | 42 |
| Shtojca II: Letër konfirmimi..... | 45 |

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës për vitin 2018, i cili e përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 10.01.2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i NP Posta e Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve nuk është menaxhuar mirë, janë identifikuar gabime financiare në prezantimin e tyre.



Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj rishikim të detajuar të PFV-ve para se të nënshkruhen nga zyrtarët përgjegjës (shih kapitullin 2).

Keq deklarimet materiale të cilat janë të përhapura në tërë pasqyrat financiare kanë ndikuar në dhënien e opinionit të kundërt për PFV-të e vitit 2018.



Kryesuesi i Bordit duhet t'i analizojë arsyet për dhënien e opinionit të kundërt për PFV-të e vitit 2018 dhe të ndërmarr veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PFV-ve në vitin 2019 (shih çështjet tek baza për opinion).

Parregullësitë e identifikuara janë kryesisht në fushën e menaxhimit të pasurive, shpenzimeve, të hyrave, llogarive të arkëtueshme, të pagueshme dhe në shënimet shpjeguese.



Kryesuesi i Bordit duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të pasurive dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet A11 deri A15, B1 dhe C1).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm i mbështetë zhvillimet në këtë fushë, mirëpo ka nevojë ende për përmirësime.



Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është filluar me procesin e identifikimit të rreziqeve dhe trajtimin e tyre (shih kapitulli 4).

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Postës së Kosovës gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e NP Posta e Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, testeve të ndërlidhura substanciale, testeve të pajtueshmërisë si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve dhe të rekomandimeve të auditimit në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë, të përgatitura dhe nënshkruara nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) të dorëzuar për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt

Kemi audituar PFV-të e Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës Sh.A për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, për shkak efekteve dhe të çështjeve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të NP Posta e Kosovës Sh.A për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit akreal të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kundërt

- Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 16, rivlerësimi i pasurive/aseteve duhet të bëhet në mënyrë të rregullt çdo tre ose pesë vjet, që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivitetit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.

Kompania për disa zëra kontabël të pronave, impianteve dhe pajisjeve, procesin e vlerësimit të aseteve për herë të fundit e kishte realizuar në vitin 2005. Në regjistrin kontabël të aseteve figuron që vlera e pasurive me kosto historike është 34,218,777€ me një zhvlerësim të akumuluar 22,926,782€ dhe vlerë neto 11,777,568€. Kjo tregon një rënie të ndjeshme në vlerën e pasurive si rezultat i mos vlerësimit të tyre për një periudhë të gjatë kohore. Grupi më i rëndësishëm i pasurive për t'u rivlerësuar janë ndërtesat që paraqesin një pjesë të konsiderueshme të pasurive.

Çështja e rivlerësimit të aseteve është trajtuar edhe në raportin e auditimit financiar për vitin 2017, mirëpo sipas zyrtarëve të Kompanisë mungesa e burimeve financiare dhe afarizimi me humbje kanë ndikuar në mos marrjen e veprimeve për një procedurë të tillë.

- Korniza konceptuale shërben për të përcaktuar konceptet bazë që duhet të mbahen parasysh për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm. Sipas kësaj kornize, një pasuri është një burim i kontrolluar nga njësi ekonomike si rezultat i ngjarjeve të shkuara dhe nga të cilat priten të hyjnë përfitime të ardhme në njësi. Pra, bazë e përcaktimit të pasurisë është kontrolli mbi të, i cili nuk kuptohet si kontroll ligjor apo titull pronësie ligjore mbi pasurinë, por si kontroll ekonomik mbi të.

Sipas informatave të ofruara nga zyrtarët e PK-së, 19 prona janë të uzurpuara nga operatori publik postar i Serbisë, mbi të cilat Posta e Kosovës nuk ka kontroll dhe nuk realizon përfitime ekonomike nga këto prona. Trembëdhjetë¹ prej tyre janë regjistruar në sistem të kontabilitetit në vlerë prej 264,540.48 euro, duke mbivlerësuar pasurinë e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Më tutje, në gjashtë apartamente banesore në Prishtinë, Kompania nuk ka kontroll dhe nuk realizon përfitime ekonomike nga këto prona. Si rezultat i kësaj, vlera pasurive e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar është mbivlerësuar për vlerën neto të këtyre pasurive për 114,900.48 euro, si dhe zëri 'shpenzimet e zhvlerësimit' në pasqyrën e fitimit/humbjes është mbivlerësuar për vlerën 19,149.96 euro. Kjo situatë është trashëguar që nga viti 2011, me rastin e ndarjes së kompanisë Posta dhe Telekomit i Kosovës në dy kompani të veçanta (Posta e Kosovës sh.a dhe Telekomit i Kosovës sh.a) në bazë të vendimit të qeverisë/ aksionarit nr. 16/53/. Më tutje, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme ligjore për zgjidhjen e këtyre çështjeve, si dhe mos aplikimi i standardeve për trajtimin kontabël të tyre.

¹ Ndërtesa – Objekti Vjetër - Prizren; Ndërtesa Dragash – Prizren, Objekti i vjetër; Ndërtesa vjetër PTK, Rr, Adem Jashari Mitrovicë; Ndërtesa Pasjan – Gjilan; PTK Ndërtesa Leshak – Mitrovicë; PTK Ndërtesa Leposaviq – Mitrovicë; PTK Ndërtesa Prilluzhë – Mitrovicë; PTK Zyra Postare Zveçan – Mitrovicë; PTK Ndërtesa Banjskë – Mitrovicë; PTK

- Posta e Kosovës ndjek rregullat e Unionit Universal Postar (UPU) sa i përket dërgesave ndërkombëtare. Duke u referuar Konventës së UPU (Neni 34) është vendosur sistemi i kompensimit dypalësh në mes të administratave postare ndërkombëtare të cilat pranojnë dhe realizojnë dërgesa. Sipas këtij sistemi harmonizimet dypalëshe bëhen duke aplikuar formularë të caktuar përmes të cilëve bëhet pranimi bilateral i trafikut postar, e pastaj pasi që pranim/dërgesat të janë pranuar plotësisht, administrata postare debitore përmbledh këtë në një llogari të përgjithshme në formularin C52 me ç’rast lëshohet fatura. Pra, në praktikë ndodhë shlyerja e llogarive të arkëtueshme tregtare kundrejt llogarive të pagueshme tregtare, pa përdorim të arkës. Për këtë arsye nevojiten regjistrimet kontabël që të transferohet shuma midis llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme për një klient/furnitor të caktuar.

Sipas SNK 10.8 një njësi ekonomike do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarje të korrigjueshme pas periudhës së raportimit. Po ashtu, sipas SNK 10.18 është e rëndësishme për përdoruesit të dinë se kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare, pasi pasqyrat financiare nuk reflektojnë ngjarje pas kësaj date.

Entiteti nuk ka praktikuar regjistrimet kontabël që të transferohen shumat midis llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme. Në pasqyrat financiare janë prezantuar saldot debitore-llogaritë e arkëtueshme për shërbime të postës ndërkombëtare në vlerë prej 751,478€, dhe saldot kreditore-llogaritë e pagueshme për shërbime të postës ndërkombëtare 185,821€.

Për shkak të natyrës së trafikut postar ndërkombëtar, pothuajse përgjatë gjithë vitit pasues/pas periudhës së raportimit, ndërmjet administratave postare ndërkombëtare kryhen harmonizime (siç përshkruhet më lartë) për ngjarje apo transaksione të vitit paraprak (në këtë rast vitit 2018). Prandaj shumë transaksione pas datës së raportimit mbesin si të pa korrigjuara. Po ashtu entiteti nuk ka aplikuar një datë specifike dhe uniforme të prerjes për korrigjimet pas datës së raportimit për të gjithë furnitorët/klientët e postës ndërkombëtare. Rrjedhimisht, ekzistojnë diferenca të theksuara ndërmjet dokumenteve burimore për transaksionet e vitit 2018 dhe atyre të prezantuara në pasqyra financiare. Prandaj, plotësia e transaksioneve të tilla nuk ishte e mundur të konfirmohet. Kjo ka ndodhur për shkak që nuk janë praktikuar regjistrimet adekuate kontabël sipas SNK 10, si dhe për shkak të natyrës komplekse të aktivitetit të postës ndërkombëtare.

Kjo ngjarje rezulton me pasqyrim jo të drejtë, për shkak se të arkëtueshmet si dhe të pagueshmet janë mbivlerësuar në vlerën 181,009 € si dhe nuk janë bërë shpalojë e duhura në shënimet shpjeguese lidhur me ngjarjet/transaksionet e vitit 2018 që nuk janë reflektuar në pasqyrat financiare.

- Sipas udhëzimeve të SNK 37 aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, mirëpo për këto duhet të jepen informacione shpjeguese. Seksioni i të arkëtueshmeve përmban zërin kontabël llogari tjera të arkëtueshme, në kuadër të të cilit janë përfshirë lloje të ndryshme të kërkesave ndaj palëve të treta për arkëtimet e mjeteve monetare nga ana e Kompanisë, për të cilat janë identifikuar çështjet në vijim:

-Blerësit e shërbimeve tjera postare në shumën 76,151€ është zë i përfshirë në kuadër të llogarive të arkëtueshme. Bazuar në raportin e Auditorit të brendshëm të Postës së Kosovës Nr. 01-2888/15 të datës 18.12.2015, Raportit final të Komisionit mbi kërkesat e hapura për shërbimet ndaj Western Union Nr. 01-2645/15 dt. 23.11.2015 si dhe vendimit të Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës 01-130/2016 dt. 18.01.2016, Posta e Kosovës me 03.02.2016 ka bërë kërkesë për hetime në Policinë e Kosovës. Sipas kësaj kërkesë ekziston dyshimi i bazuar që zyrtarë të caktuar të Kompanisë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare kanë përvetësuar shumën prej 76,151€. Aktualisht lënda është ende në procedim në gjykatë edhe ende nuk ka një vendim final.

Kompania këtë ngjarje e ka njohur në kontabilitet si llogari e arkëtueshme ndaj Pikës Postare nr.10, në vend që të njohë këto si pasuri kontigjente sipas udhëzimeve të SNK 37. Një regjistrim i tillë ka ndikuar në mbivlerësimin e të arkëtueshmeve për 76,151€.

-Kërkesat për të punësuarit në shumën 254,801€, nga të cilat 253,584€ janë kërkesa për plaçkitjet (vjedhjet), të cilat kanë ndodhur në zyrat postare në vitet 2012-2018. Llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuar për këtë shumë, sepse këto kërkesa do të duhej të prezantoheshin vetëm tek shënimet shpjeguese si pasuri kontigjente.

- Sipas SNK 2.6 Stoqet janë aktive të mbajtura për shitje në rrjedhën normale të biznesit.

Posta e Kosovës sh.a ka lidhur kontratë me Telekomin e Kosovës sh.a për shitjen e mbushjeve elektronike përmes postierëve të Postës. Ky shërbim ka të bëjë me shitjen në terren të mbushjeve elektronike të telefonisë mobile nga postierët duke shfrytëzuar teknologjinë USSD (përmes aparateve të posaçëm). Për shitjet e realizuara Posta përfiton provizionin e shërbimit të përcaktuar në kontratë.

Mbushjet elektronike të blera për shitje përmes sistemit USSD u janë ngarkuar postierëve dhe janë trajtuar në kontabilitet si llogari të arkëtueshme në vend që të trajtohen si stoqe siç përcaktohet me SNK 2.6. Vlera e llogarive të arkëtueshme për shërbimin USSD është 84,862. Kjo ngjarje rezulton me pasqyrim jo të drejtë, për shkak se të arkëtueshmet janë mbivlerësuar në shumën 84,862 €, pasi që kjo vlerë përfaqëson vlerën e stoqeve/mbushjeve elektronike të pa shitura në periudhën e raportimit. Prandaj edhe vlera e stoqeve është e nënvlerësuar për të njëjtën shumë.

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimi të standardit në mënyrë adekuate.

- Llogaria TVSH e zbritshme (arkëtueshme) është llogari e pasurive. Ajo me tepricën debitore do të tregojë shumat për t'u arkëtuar nga shteti për TVSH. Në Pasqyrën e pozicionit financiar ajo do të pasqyrohet në seksionin e të arkëtueshmeve.

Kompania, arkëtimet për TVSH i kishte prezantuar në shumën 740,282.95€. Mirëpo, nga analizat tona të bëra bazuar në deklaratat tatimore për këtë llogari tatimore, gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatim paguesit, si dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga Administrata Tatimore rezulton se Posta e Kosovës nuk është debitore ndaj Administratës Tatimore për këtë llogari tatimore. Diferenca prej 740,282.95€, ndërmjet shumës së prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të konfirmimit nga ATK, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar të arkëtueshmet.

- TVSH e pagueshme është llogari e detyrimeve. Ajo me tepricën kreditore do të tregojë detyrimin e papaguar ndaj shtetit për TVSH-në. Në pasqyrën e pozitës financiare ajo do të pasqyrohet në seksionin e detyrimeve afatshkurtra.

Kompania, detyrimet për TVSh i kishte prezantuar në shumën 809,227.35€. Mirëpo, nga analizat tona të bëra bazuar në deklaratat tatimore për këtë llogari tatimore, gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatim paguesit, si dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga Administrata Tatimore rezulton se Kompania është kreditore ndaj Administratës Tatimore për shumën 313,141.83€ për këtë llogari tatimore. Diferenca prej 496,085.52€, ndërmjet shumës së prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe detyrimin të konfirmuar nga ATK, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra. Kjo ka ndodhur si shkak i mos prezantimit të tepricës përfundimtare të llogarisë së TVSH-së në pasqyrën e pozicionit financiar si dhe mos harmonizimit të të dhënave kontabël me deklaratat tatimore dhe pagesat e bëra për to.

- Llogaria e detyrimit për tatimin mbi pagat është llogari e tatimit për të ardhurat personale. Pagesën e këtyre tatimeve punonjësit nuk e bëjnë vetë drejtpërdrejtë në zyrat fiskale shtetërore, por për llogari të tyre e bënë njësia ekonomike (Kompania) ku ata punojnë. Kompania ndalë këto tatime nga paga e secilit punonjës dhe merr kështu ajo përsipër detyrimin ndaj shtetit për pagimin e tyre. Për sa kohë që këto tatime janë llogaritur dhe ndalur nga Kompania, por që nuk i janë paguar ende shtetit, ato përbëjnë një detyrim afatshkurtër të Kompanisë.

Detyrimi për tatimin në paga i prezantuar në bilanc ishte 398,658€. Nga trajtimi i jonë i kësaj llogarie, bazuar në deklaratat tatimore dhe gjendjes së deklarimeve dhe transaksioneve të tatimpaguesit (dokument i Administratës Tatimore), rezulton se detyrimi i kompanisë në fund të vitit 2018 ishte 389,721€. Për shkak të kësaj diference, detyrimet afatshkurtra janë mbivlerësuar për 8,937€.

- Llogaria për kontributet e pensioneve të pagueshme është llogari e detyrimeve të cilat i paguajnë punonjësit e kompanisë. Pagesën e tyre punonjësit nuk e bëjnë vetë drejtpërdrejtë në zyrat fiskale shtetërore, por për llogari të tyre e bënë kompania ku ata punojnë.

Kompania të pagueshmet për kontributet e pensioneve, në bilanc i kishte prezantuar në shumën 299,233€. Mirëpo, nga analizat tona të bëra bazuar në deklaratat tatimore, gjendjen e përgjithshme të deklarimeve e transaksioneve tjera të tatimpaguesit si dhe nga letër konfirmimi i pranuar nga Administrata Tatimore, konfirmohet se Kompania, është kreditore ndaj Administratës Tatimore, për shumën 251,611€ për këtë llogari tatimore. Diferenca ndërmjet shumës së prezantuar në bilanc dhe detyrimit të konfirmuar, në shumën prej 47,712€, është shumë për të cilën janë mbivlerësuar detyrimet afatshkurtra.

Shkak i këtyre diferencave është mos harmonizimi i të dhënave kontabël me deklaratat tatimore dhe pagesat e bëra për këtë llogari tatimore.

- Sipas SNK 20, Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, njihen fillimisht si të hyra të shtyra dhe transferohen një pjesë në të ardhura çdo vit, duke kompensuar kështu shpenzimin më të madh të zhvlerësimit në koston fillestare.

MZHE ka mbështetur projektin kapital të Postës së Kosovës për renovimin e rrjetit VPN me grant në vlerë prej 487,903€. Pajisjet e rrjetit VPN janë futur në përdorim në tetor 2017, mirëpo zhvlerësimi i akumuluar për tre muaj të vitit 2017 nuk ishte njohur si e hyrë e vitit 2017, por si e hyrë e vitit 2018. Kjo ka shkaktuar mbivlerësim të të ardhurave të vitit 2018 për 24,397.38 €. Rrjedhimisht kjo ka ndikuar po ashtu që humbja e vitit financiar në pasqyrën e fitimit ose humbjes për periudhën, të jetë nënvlerësuar për 24,397.38€.

- Posta e Kosovës ka licencë nga Banka Qendrore e Kosovës për kryerjen e shërbimeve të pagesave, si Institucion Financiar Jo Bankar (IFJB). Në bazë të marrëveshjes së grumbullimit të të hyrave publike (për të gjitha institucionet publike) në mes të Postës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave Nr. 01-3447/13, provizioni që përfiton PK për pagesat nën 10 € është 0.5 € ndërsa për pagesat mbi 10 € provizioni i fituar nga PK është 1€. Në muajin Gusht 2018 Komuna e Prishtinës kë nënshkruar një marrëveshje të re Nr. 14-024/01-0190592/18 me PK për pagesat nga faturat për grumbullimin e mbeturinave, në të cilën marrëveshje çmimi i provizionit të përfituar nga PK pavarësisht shumës së pagesës është 0.4€.

Posta e Kosovës ka vazhduar të faturojë në bazë të marrëveshjes së vjetër (Nr. 01-3447/13) deri në muajin Tetor 2018. Në muajin dhjetor 2018 është lëshuar një kredit notë ndaj Komunës së Prishtinës përmes së cilës është korrigjuar faturimi i muajit gusht-tetor 2018 i cili ishte bërë gabimisht në bazë çmimeve të kontratës së vjetër. Mirëpo ky korrigjim është aplikuar edhe për muajt janar-korrik e për të cilët muaj marrëveshja e re ende nuk ishte në fuqi. Kredit nota është lëshuar me urdhër të Menaxherit të Shitjes, me arsyetimin që të mos grumbullohet edhe më shumë borxhi nga Komuna e Prishtinës si dhe për shkak të bashkëpunimit të mirë që PK ka pasur me këtë komunë.

Kjo ka shkaktuar nënvlerësim të të ardhurave të vitit 2018 për 21,743.5€. Rrjedhimisht, nënvlerësimi i të ardhurave ndikon që humbja e vitit financiar në pasqyrën e fitimit ose humbjes së periudhës të jetë nënvlerësuar për 21,743.5€.

- Sipas SNK 18, Të ardhurat, paragrafi 10 thekson se : “ Shuma e të ardhurave që rrjedhin nga një transaksion zakonisht përcaktohet me marrëveshje ndërmjet njësisë ekonomike dhe blerësit ose përdoruesit të aktivitetit. Ajo matet me vlerën e drejtë të shumës së pranuar ose të arkëtueshmeve duke marrë parasysh shumën e çdo zbritjeje tregtare dhe uljen e vëllimit të lejuar nga njësia ekonomike.”

Kompania kishte aplikuar zbritje tregtare (shitjeje) për 7 klientë të mëdhenj, në vlerë prej 9,048€. Këto zbritje do të duhej të regjistroheshin si kundër llogari e të ardhurave duke reduktuar shitjet në shitje neto, mirëpo ato ishin regjistruar në konto jo adekuate duke i njohur si të hyra të shtyra. Kjo shumë prej 9,048€, ka shkaktuar mbivlerësim të të hyrave të shtyra.

Kjo ka ndodhur si shkak i mos zbatimit të plotë të SNK 18 për të hyrat, gjatë trajtimit kontabël të transaksioneve të hyrave dhe zbritjeve tregtare.

- Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare të saj, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e parasë, mbi bazën e kontabilitetit rritës. Qëllimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë, sipas SNK 7, është për të plotësuar nevojat e përdoruesve të informacionit kontabël në lidhje me rezultatin monetar, me fluksin e lëvizjes së mjeteve monetare gjatë një periudhe kontabël.

Kompania kishte hartuar pasqyrën e rrjedhës së parasë, mirëpo bazuar në çështjet e ngritura më sipër për zërat kontabël, të arkëtueshmet, të pagueshmet, stoqet, zhvlerësimi, zëra që kanë ndikim në rrjedhën e parasë nga aktivitetet operative, vijnë në përfundim se rrjedha e parasë nuk prezanton një informacion të saktë.

- Sipas SNK 1 një pako e pasqyrave financiare duhet për përmbajë edhe një pasqyrë të ndryshimeve në ekuitet e cila paraqet një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve në ekuitet. Kompania kishte hartuar pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, mirëpo për shkak të çështjeve të ngritura në lidhje me të hyrat dhe shpenzimet e zhvlerësimit që kanë ndikim në rezultatin financiar në pasqyrën e të ardhurave, humbja e periudhës e bartur në këtë pasqyrë nuk është e saktë.
- Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese janë një element i pandarë i pasqyrave financiare. Sipas përcaktimeve të bëra në këtë standard këto shënime të pasqyrave financiare duhet të:

-Paraqesin informacion në lidhje me bazat e përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare. Sipas SNK 1 një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat financiare, me përjashtim të informacionit mbi rrjedhën e arkës, mbi bazën akruale (bazë e kontabilitetit rritës).

Edhe pse në fillim të shënimeve shpjeguese, Kompania ka bërë deklaratën e pajtueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtim me SNRF, ajo nuk ka paraqitur informacion të qartë në pjesën narrative mbi bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

-Paraqesin informacione në lidhje me politikat kontabël të zgjedhura e të aplikuara për ngjarjet dhe veprimet më të rëndësishme. Sipas SNK 1 seksioni që paraqet politikat kontabël të përdorura duhet të përshkruajë bazën e matjes së përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare, si dhe çdo politikë kontabël specifike e cila është e nevojshme për një kuptim të përshatshëm të pasqyrave financiare.

Kompania nuk ka qenë e kujdesshme ndaj bazës së matjes në rastin e pasurive për të cilat thuhet se “pronat janë të modifikuara sipas vlerave të rivlerësuar”, ndërsa në bilanc ato janë të paraqitura të pa vlerësuar për një periudhë të gjatë kohore. Më tutje, në rastin e stoqeve përmenden të gjitha metodat e mbajtjes së stoqeve mirëpo, përshkrimi është i pasaktë lidhur me metodën e mbajtjes së tyre.

-Sa i përket kërkesave të SNK 7 dhe SNRF 7 në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese për paranë e gatshme që nuk është në dispozicion për përdorim dhe për aktivitetet financuese të rrjedhës së parasë së gatshme, është vërejtur që nuk janë dhënë shpallje për: shumën e parasë prej 250,000€ që është afatizuar në afat prej 60 muajsh si dhe rrjedhën e parasë së gatshme për aktivitetet financuese.

Për veç kësaj, shpalljet nuk mund të kuptohen nga pjesa narrative sepse nuk janë prezantuar politikat specifike kontabël për: borxhet e këqija, humbja e vlerës së

inventarit; vlera e drejtë e pasurive financiare/ jo financiare apo detyrimeve financiare; jeta e dobishme e pasurive jo financiare dhe detyrimet e garancisë.

-Paraqesin informacion në lidhje me hipotezën e vijimësisë - Kur menaxhmenti është i ndërgjegjshëm, në bërjen e vlerësimit për pasiguritë materiale të lidhura me ngjarjet ose kushtet të cilat mund të hedhin dyshime mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë, për këto pasiguri duhet të jepen informacione shpjeguese.

Menaxhmenti i Postës së Kosovës nuk ka parashikuar ndonjë pasiguri materiale lidhur me vijimësinë e kompanisë. Sipas menaxhmentit, duke u nisur nga pasuria të cilën disponon kompania, potencialin e burimeve njerëzore, planeve vjetore dhe afatmesme si dhe interesit publik të cilin e ka kjo kompani, parimi i vijimësisë nuk rrezikohet dhe kompania ka mundësi të operoj edhe në periudhën e ardhshme.

Sipas gjykimit tonë, duke u bazuar në dëshmitë e auditimit, ekzistojnë pasiguri materiale të cilat individualisht ose kolektivisht mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e njësisë për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë. Për këtë, është e nevojshme të bëhet shpalosja e tyre në kuptimin e raportimit financiar të drejtë si dhe në kuptimin që pajtueshmëria me kornizën e raportimit të mos jetë mashtruese.

Ne kemi identifikuar këto pasiguri materiale që do të duhej të shpaloseshin në shënimet shpjeguese:

Posta e Kosovës, të hyrat kryesore i realizon nga Telekom i Kosovës (TK) përkatësisht rreth 53% (5,905,412€) e të ardhurave të përgjithshme realizohen nga ky klient. Rreth 70% (4,139,965€) e të hyrave që realizohen nga TK kanë të bëjnë me qiranë e objekteve, ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me shërbimet tjera të shitjes që Posta e Kosovës kryen për TK.

Duke i'u referuar , informatave që ka pranuar ZKA gjatë auditimit të Telekomit të Kosovës për vitin 2018, ekzistojnë pasiguri materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Kompanisë (TK) për të realizuar pasuritë e saj dhe të kryejë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Prandaj, nëse pasiguritë e tilla në TK materializohen kjo mund të ketë efekt edhe në Postën e Kosovës duke dështuar që të sigurojë rreth 50% e të hyrave të planifikuara.

Sipas gjykimit tonë ky është një rrezik potencial që duhet shpalosur.

Posta e Kosovës ka vazhduar trendin e operimit me humbje, përkatësisht në vitin 2015 humbja totale që i atribuohet pronarëve/aksionarit ishte 3,043,774 €, në vitin 2016 humbja ishte 1,584,554 €, në vitin 2017 humbja ishte 1,942,991 €, dhe në vitin 2018 humbja e paraqitur në pasqyra financiare ishte 2,333,841€.

Për më tepër, Kapitali aksionar i emetuar si dhe komponentët tjera të kapitalit në vlerën 30,038,345€ është zvogëluar nga humbjet e akumuluar në vlerë 18,847,408€ që d.m.th.

se vlera e mbetur e ekuitetit është 11,715,937€. Nëse vazhdon trendi i tillë vlera e ekuitetit mund të bie në zero.

Sipas gjykimit tonë kjo situatë përbën pasiguri për entitetin dhe si e tillë duhet shpalosur.

Menaxhmenti beson se është duke ndërmarrë veprimet adekuate për të siguruar stabilitet financiar për Postën e Kosovës. Kjo përmes një kërkesë/plani të datës 15.11.2017 drejtuar Qeverisë së Kosovës ku kërkohet që një varg shërbimesh financiare jo bankare të Qeverisë të kryhen përmes Postës së Kosovës. Po ashtu, menaxhmenti konsideron se për shkak të pozitës së përshtatshme të objekteve postare në territorin e vendit, është e mundur që objektet të lëshohen me qira për kompani të tjera në rast se marrëveshja e qirasë me TK dështon për ndonjë arsye.

-Sipas SNK 20 për grantet qeveritare duhet të jepen informacione shpjeguese për politikën kontabël të përdorura për grantet, natyrën dhe madhësinë e granteve qeveritare të njohura në pasqyrat financiare, dhe kushtet e paplotësuara të lidhura me ndihmën qeveritare.

Analizat tona për dy grantet e dhëna nga Qeveria tregojnë se për: grantin e dhënë për asete (investime) – për realizimin e projektit kapital të Renovimit të Rrjetit VPN, në shumën 487,903€ (vlera e të hyrave të njohura nga zhvlerësimi i akumuluar i grantit/pajisjeve në pasqyrat financiare të vitit 2018 është 121,986€), si dhe për grantin për mbulimin e humbjeve të shërbimit universal postar, në shumën 100,000€, Kompania përveç definicioneve për grantet nuk ka dhënë informacione shpjeguese për to në përputhje me kërkesat e SNK 20.

- Sipas SNK 37 njësia ekonomike duhet të jap informacion shpjegues për pasuritë dhe detyrimet kontingjente (eventualitetet) përveç kur mundësia e një hyrje/daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më.

Kompania për ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si pasuri kontingjente nuk i ka trajtuar si të tilla dhe nuk ka dhënë informacione shpjeguese për to. Ato ngjarje ekonomike janë trajtuar si llogari të arkëtueshme.

Përveç kësaj, Kompania nuk kishte bërë një vlerësim të detyrimeve kontingjente. Ekziston një listë e padive të hartuar nga zyra ligjore që ka të bëjë me konteste të punëtorëve, konteste civile dhe konteste përmbartimore ndaj Kompanisë, mirëpo nuk është dhënë asnjë informacion shpjegues në lidhje me kontestet, të cilat janë materiale për nga natyra dhe gjasa e ndodhjes së detyrimit që është më e lartë.

- Sipas SNK 1, një grup i plotë i pasqyrave financiare të publikueshme për qëllime të përgjithshme përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar në fund të periudhës, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën, dhe shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Kompania kishte përgatitur pasqyrat financiare, por nuk i kishte emërtuar ato sipas Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF).

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP-ve në Kosovë, ZKA është i pavarur nga NP Posta e Kosovës Sh.A dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion të kundërt.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Menaxhmenti i NP Posta e Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keq deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysht:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbushin edhe kërkesat si në vijim:
 - Statutin e NP-së;
 - Planin e Biznesit;
 - Raportet tremujore;
 - Raportin vjetor;
 - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së konsumatorëve; dhe
 - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Në PFV-të të datës 26/04/2019 mungonin shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimet shpjeguese, përfshirë pjesën narrative. Ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar në fushat përkatëse dhe tek baza për opinion.

Marrë parasysht çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH me rastin e dorëzimit në BD, nuk mund të konsiderohen të sakta.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Për çështjet e sipërpërmendura, jepen rekomandimet:

-
- Rekomandimi A1** Kryesuesi i Bordit të merr vendim për inicimin e procedurës për rivlerësim të pasurive e cila është e domosdoshme për paraqitjen e vlerave reale të pasurive në pasqyra financiare dhe eliminimin e mundësisë së nënvlerësimit të tyre.
- Rekomandimi A2** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për trajtimin e pronave të uzurpuara në regjistra të veçantë të pasurive dhe trajtimet e duhura kontabël, përfshirë shpalosjet e nevojshme/mjaftueshme në pasqyra financiare si dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime ligjore që të krijoj qasje në të gjitha pronat e Postës së Kosovës.
- Rekomandimi A3** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se po praktikohen regjistrimet kontabël që të transferojnë shumat ndërmjet të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve për një klient/furnitor të caktuar të postës ndërkombëtare. Përveç kësaj, të bëhen korrigjimet për të reflektuar ngjarje të korrigjueshme pas periudhës së raportimit deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare, ndërsa të bëhen shpalosjet e duhura duke dhënë shënime shpjeguese që pasqyrat financiare nuk reflektojnë ngjarje pas datës së publikimit.
- Rekomandimi A4** Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjuese për zërat kontabël: të arkëtueshmet, stoqet, kërkesat tjera, të pagueshmet dhe të hyrat e shtyra, për të siguruar gjendje dhe prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi A5** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël të jenë harmonizuar me gjendjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore për TVSH, tatimin mbi pagat dhe kontributet e pensioneve.
- Rekomandimi A6** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprime korrigjuese në mënyrë që të hyrat të njihen saktë duke përfshirë zbritjet tregtare, si dhe të hyrat nga grantet të njihen në periudhën e duhur kontabël.
- Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë masat e duhura për vendosjen e kontroleve adekuate të cilat mundësojnë zbatim adekuat të kontratave përmes të cilave ndërmarrja zhvillon aktivitetet afariste.
- Rekomandimi A8** Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek rrjedha e parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.
-

Rekomandimi A9 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

Rekomandimi A10 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit. Po ashtu, të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, duhet të bëhet vetëm pasi që janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme, para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në NP Posta e Kosovës. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin financiar të Postës së Kosovës sh.a nuk janë në nivelin e duhur. Rezultatet tona të auditimit kanë nxjerrë në pah dobësi të shumta në këtë fushë, të cilat nevojitet të adresohen nga menaxhmenti për të siguruar procese efektive të kontrollit dhe të dizajnuara në mënyrë të tillë që të prodhojnë rezultate pozitive në të ardhmen.

Pronësia e pa definuar e pasurive, mos prezantimi i saktë i të pagueshmeve tregtare, mungesa e rregullores për menaxhimin e të hyrave, dhe çështjet që kanë ndikuar në modifikimin e opinionit, janë dobësitë të cilat kanë pamundësuar regjistrimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të këtyre llogarive si në regjistrat kontabël ashtu edhe në PFV.

Dobësitë e theksuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin tek Posta e Kosovës.

3.1 Plani i biznesit (të hyrat dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit, sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)

| Përshkrimi | Planifikimi fillestar | Plani përfundimtar | Realizimi 2018 | Realizimi 2017 |
|-----------------------------------|-----------------------|--------------------|-------------------|-------------------|
| Të hyrat nga shitjet/shërbimet | 8,151,778 | 7,458,021 | 6,488,504 | 7,604,475 |
| Të hyrat nga interesi | - | - | - | - |
| Të hyrat nga subvencionet | 1,127,494 | 1,127,494 | 100,000 | - |
| Të hyrat nga qiraja | 4,242,074 | 4,242,074 | 4,230,427 | 4,174,441 |
| Të hyrat tjera ² | 32,456 | 29,053 | 213,454 | 74,712 |
| Gjithsej të hyrat | 13,553,803 | 12,856,642 | 11,032,384 | 11,853,628 |
| Shpenzimet për paga | 9,231,373 | 9,231,373 | 9,070,301 | 9,052,821 |
| Shpenzimet operative ³ | 1,740,171 | 1,723,308 | 1,477,994 | 1,641,156 |
| Shpenzimet tjera ⁴ | 2,753,187 | 2,894,802 | 2,817,930 | 3,102,642 |
| Gjithsej Shpenzimet | 13,724,732 | 13,849,484 | 13,666,225 | 13,796,619 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi fillestar i të hyrave nga shitjet/shërbimet ishte më i ulët sesa plani final për 693,757 € ose 8.5%. Indikator kryesor për këtë ishte trendi i realizimit të të hyrave për pjesën e parë të viti 2018, andaj si rezultat i kësaj, në drejtim të një planifikimi më real nga Kompania, në planin me rishikim, të hyrat janë paraparë më të ulëta sesa në atë fillestar. Megjithatë, ndërmarrja kishte realizim të mirë krahasuar me planin final, e që shprehur në përqindje është rreth 86%;
- Planifikimi fillestar dhe ai final për të hyrat nga subvencionet ishte i njëjti. Përderisa realizimi (ndarja) ishte vetëm 100,000€ apo shprehur në përqindje rreth 9% e vlerës së planifikuar;
- Planifikimi fillestar dhe ai final për të hyrat nga qiraja ishte i njëjti. Po ashtu edhe realizimi në këtë kategori të të hyrave ishte pothuaj i njëjtë me planin, e që shprehur në përqindje është rreth 100%;
- Planifikimi fillestar i të hyrave tjera ishte më i ulët sesa plani final për 3,404 €. Përderisa, realizimi ishte për 184,400€ më i lartë sesa plani final. Këtë realizim e përbejnë kryesisht:

² Paraqet totalin të hyrave tjera. Totali i të hyrave duhet të jetë i njëjtë me atë në Planin e biznesit

³ Shpenzimet operative përfshijnë: shpenzimet për mirëmbajta, derivate, të konsulences, të sigurimit, të qirasë, telefonit, administrative dhe komunalit etj.

⁴ Paraqet totalin e të gjitha shpenzimeve tjera. Totali duhet të jetë i njëjtë me atë të Planit të biznesit

- të hyrat e realizuara nga provizionet e borxheve të këqija, nga shitja e mjeteve themelore, nga penaltitë dhe të hyrat tjera jo operative;
- Planifikimi final për paga dhe mëditje ishte i njëjti me planifikimin fillestar. Plani për këtë kategori për 2018 është realizuar rreth 98%;
- Planifikimi final për shpenzime operative në raport me planifikimin fillestar është zvogëluar për 16,863€ ose rreth 1%. Plani final për këtë kategori është realizuar rreth 86%;
- Planifikimi final për shpenzime tjera në raport me planifikimin fillestar është rritur për 141,615€ ose rreth 5%. Plani final për këtë kategori është realizuar rreth 97%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ndërmarrja publike Posta e Kosovës në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha pasuritë, detyrimet dhe ekuitetin.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare (Balanci i Gjendjes)⁵ sipas PVF-ve të PK-së, më 31 dhjetor 2018 (në €)

| Pasuritë | Viti 2018 | Viti 2017 |
|--|-------------------|-------------------|
| Toka | 196,800 | 196,800 |
| Objektet ndërtimore | 9,723,407 | 10,976,103 |
| Investime në vijim | 480,337 | 1,060,252 |
| Pajisjet dhe makineritë | | |
| Veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese | 669,732 | 1,011,690 |
| Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera | 702,056 | 313,245 |
| Stoqet | 193,459 | 181,000 |
| Llogaritë e arkëtueshme | 1,103,924 | 1,341,599 |
| Kërkesat tjera | 1,516,882 | 1,345,038 |
| Pasuritë tjera financiare joqarkulluese | 5,237 | 5,237 |
| Paraja në bankë dhe arkë | 1,045,575 | 2,818,598 |
| Gjithsej Pasuritë | 15,637,409 | 19,249,562 |
| Ekuiteti | | |
| Kapitali themelor | 525,000 | 525,000 |
| Kapitali rezerve | 30,038,345 | 30,038,345 |
| Fitimet/Humbjet e mbajtura | (16,513,567) | (14,570,576) |
| Fitimet/Humbjet e vitit | (2,333,841) | (1,942,991) |
| Zërat tjerë | | |
| Detyrimet | | |
| Detyrimet afatgjata | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare | 869,751 | 2,666,974 |

⁵ SNK 1 termin "Balanci i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare", por derisa kompania e ka emërtuar bilanci i gjendjes edhe ne ju kemi referuar këtij emërtimi për të qenë konsistent me emërtimin e vet PVF-ve të cilat i kemi audituar.

| | | |
|--|-------------------|-------------------|
| Llogaritë tjera të pagueshme | 1,207,880 | 541,653 |
| Obligime tjera afatshkurtra | 1,843,842 | 1,991,157 |
| Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti | 15,637,409 | 19,249,562 |

Vlera neto e pasurive e paraqitur në PFV (përfshirë: Toka, Objektet ndërtimore, Pajisjet dhe makineritë, Veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese si dhe Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera) ishte 11,772,332€. Menaxhimi i pasurisë në Kompani ka rezultuar me mangësi si në vijim:

Çështja A11 - Pronësia e pa definuar e pasurive

Gjetja Sipas Standardeve Ndërkombëtare IPSAS dhe Kornizës Konceptuale "Par.5 BC5.10 pronësia ligjore e një pasurie si një qasje në shërbime potenciale ose në përfitime ekonomike të një pasurie është një tregues i kontrollit. Megjithatë, të drejtat për shërbime potenciale ose aftësia për të gjeneruar përfitime ekonomike mund të ekzistojë pa pronësinë ligjore të pasurisë nëpërmjet mbajtjes dhe përdorimit të pronës.

Sipas sistemit të kontabilitetit ERP dhe Raportit të Regjistrimit të Mjeteve Themelore dt. 31 dhjetor 2018, janë prezantuar gjithsej 132 Ndërtesa. Më tej, sipas dëshmive të ofruara nga zyrtarët e Kompanisë, pronat me status ligjor të konfirmuar mbi të cilat ndërmarrja ushtron të drejtat pronësore janë gjithsej nëntë, ndërsa nëntë tjera janë në shfrytëzim nga Kompania, ku në dy prej tyre Kompania ka të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm sipas akt vendimeve të gjykatave. Për pjesën tjetër të pasurive/pronave statusi ligjor mbi pronësinë është i pa definuar.

Rreziku Mungesa e pronësisë me status ligjor të konfirmuar për shumicën e pronave në ndërmarrje, krijon paqartësi pronësore dhe e rrit rrezikun që ndërmarrjes t'i pamundësohet ushtrimi i të drejtave pronësore mbi pronat që potencialisht janë të saj.

Rekomandimi A11 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave dhe të zgjidhen kontestet ligjore lidhur me këto pasuri.

Çështja A12 – Mos prezantimi i saktë i të pagueshmeve tregtare

Gjetja Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime që krijohen gjatë kryerjes së aktiviteteve kryesore të njësisë ekonomike. Ato krijohen si pasojë e blerjes së mallrave apo shërbimeve me pagesë të mëvonshme.

Në bazë të konfirmimeve të pranuar nga palët e treta, analizës së kartelave dhe faturave të furnitorëve, ne kemi identifikuar se kompania kishte mbivlerësuar obligimin ndaj Komunës së Kamenicës në vlerë prej 1,200€. Po ashtu, Kompania, kishte nënvlerësuar obligimin ndaj Dardafon.net për 4,292.45€ dhe Telekomit të Kosovës për 297€.

Kjo ka ndodhur si shkak i mos harmonizimit të faturave të furnitorëve me pagesat e kryera nga kompania si dhe mos barazimit me klientët, në emër të cilëve Posta shet produktet e tyre.

Rreziku Mos harmonizimi i faturave të furnitorëve me pagesat e bëra si dhe mos barazimi me klientët për produktet e pranuar dhe të shitura, përveç që mund të prezantoj një gjendje jo të saktë të obligimeve ndaj furnitorëve, po ashtu rrit rrezikun e paqartësive në barazimet e ardhshme me furnitorët/klientët përkatës.

Rekomandimi A12 Kryesuesi i Bordit të sigurojë që në mënyrë sistematike bëhen harmonizimet e shënimeve kontabël me faturat e furnitorëve dhe pagesat e bëra, dhe të prezantoj gjendjen e saktë të llogarive të pagueshme tregtare për secilën periudhë.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike Posta e Kosovës në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (sipas PFV-ve të PK-së) më 31 dhjetor 2018 (në €)

| Përshkrimi | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|--------------------|--------------------|
| Të hyrat nga shitjet/shërbimet | 10,718,931 | 11,777,963 |
| Të hyrat nga subvencionimi për shërbimin universal postar | 100,000 | - |
| Të hyrat tjera (vendos totalin të hyrave tjera nëse ka) | 213,454 | 75,665 |
| Gjithsej të Hyrat | 11,032,384 | 11,853,628 |
| Pagat dhe mëditjet | 9,070,301 | 9,052,820 |
| Shpenzimet e derivateve | 127,526 | 163,155 |
| Shpenzimet e materialit/shërbimeve | 668,124 | 1,136,387 |
| Shpenzimet e energjisë elektrike | 131,958 | 169,470 |
| Shpenzimet për mirëmbajtje | 517,886 | 661,123 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit | 2,149,806 | 1,966,255 |
| Shpenzimet tjera | 700,625 | 647,408 |
| Gjithsej Shpenzimet | 13,366,225 | 13,796,618 |
| Fitimi/Humbja para tatimit | (2,333,841) | (1,942,991) |
| Tatimi në fitim | - | - |
| Fitimi/Humbja neto | (2,333,841) | (1,942,991) |

Të hyrat e gjeneruara nga Kompania në vitin 2018 ishin 10,932,384€, përderisa planifikimi i të hyrave për vitin 2018 ishte 11,729,148.58€. Gjithashtu në pjesën e dytë të viti 2018, Kompania ka pranuar subvencion për shërbime universale postare në vlerë prej 100,000€.

Ne kemi ekzaminuar 151 mostra (teste thelbësore), kryesisht në të hyrat nga: shërbimet postare, filatelike, shitje direkte, të hyrat nga shërbimet e konsumatorëve të mëdhenj, nga shërbimet financiare jo bankare e të tjera të ngjashme. Ndërsa për të hyrat nga qiraja kemi aplikuar procedura analitike substanciale. Gjithashtu, kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për disa mostra.

Shpenzimet e realizuara (pa zhvlerësim dhe amortizim) nga PK në vitin 2018 ishin 11,216,419€, përderisa planifikimi i të hyrave nga PK për vitin 2018 ishte 11,804,178€. Prej këtyre shpenzimeve të realizuara 9,070,301€ ose shprehur në përqindje rreth 80% i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve (shpenzimeve të personelit).

Ne kemi ekzaminuar 100 mostra (teste thelbësore), në kategorinë e shpenzimeve të personelit (paga dhe mëditje) dhe 19 mostra në kategorinë e shpenzimeve Gjithashtu, kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për disa mostra.

Ekzaminimet tona audituese lidhur me të ardhurat kanë rezultuar me gjetjet si në vijim:

Çështja A13 - Mungesa e rregulloreve për menaxhimin e të hyrave

Gjetja Në bazë të Statutit të Shoqërisë Aksionare “Posta e Kosovës”, neni 7 paragrafi 2, përcakton që ndërmarrja duhet nxjerr rregulloret të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë.

Kompania karakterizohet me një shumëllojshmëri të të hyrave si dhe decentralizim të lartë të pikave shitëse që krijojnë të hyra. Përkundër kësaj Posta ende nuk ka hartuar procedura/rregullore të qarta dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e të hyrave.

Rreziku Në mungesë të procedurave të qarta për menaxhimin e të hyrave mund të shkaktohen gabime ose keqpërdorime eventuale.

Rekomandimi A13 Kryesuesi i Bordit të sigurojë hartimin e rregulloreve në fushën e të hyrave duke përcaktuar procedura dhe përgjegjësi të qarta për menaxhimin e secilit lloj të të hyrave.

Çështja C1 - Shpenzimet kontigjente

Gjetja Në konton shpenzime kontigjente, në fund të vitit 2018 janë prezantuar shpenzime në vlerë prej 17,162.27 euro. Këto shpenzime nuk i takojnë kësaj kategorie, por kryesisht janë shpenzime të funksionalizimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve, shpenzime të qirasë, transportit dhe disa shpenzime tjera. Për më tej, kjo çështje ishte ngritur edhe vitin e kaluar nga auditori i jashtëm.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, kjo ka ndodhur si rezultat i mos planifikimit të këtyre shpenzimeve.

Rreziku Prezantimi jo i saktë i shpenzimeve shkakton, mbivlerësim dhe nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe një prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare.

Rekomandimi C1 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i eliminuar gabimet në regjistrimet dhe prezantimin e shpenzimeve duke siguruar raportim të drejtë të tyre.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike (sipas PVF-ve të PK-së) më 31.12.2018

| Përshkrimi | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|-------------------------------|-----------------|-----------------|
| KAPITALI | | |
| Kapitali themeltar | 525,000 | 525,000 |
| Kapitali rezervë | 30,038,345 | 30,038,345 |
| Fitimet/Humbjet e bartura | (16,513,567) | (14,570,576) |
| Fitimet/Humbja e vitit aktual | (2,333,841) | (1,942,991) |
| Rezerva e rivlerësimit | | |

Çështja e cila ka rezultuar prej ekzaminimeve tona lidhur me këtë pasqyrë, është prezantuar në bazën për opinion.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investive dhe ato financiare. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme sipas PVF-ve të PK-së (në €)

| Përshkrimi | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|--|--------------------|------------------|
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i> | | |
| Korrigjimi për zhvlerësim | 2,149,806 | 1,966,255 |
| Korrigjimet tjera rritëse | | |
| Zvogëlimi i parasë (Humbja para tatimit dhe tjera) | (3,624,612) | (2,218,835) |
| Korrigjimet tjera rritëse zvogëluese | 65,830 | 2,479,749 |
| Rrjedha neto nga aktivitetet operative | (1,408,976) | 2,227,169 |
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</i> | | |
| Rritja e parasë | | |
| Zvogëlimi i parasë | (364,047) | (362,651) |
| Paratë neto nga aktivitetet investive | (364,047) | (362,651) |
| <i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i> | | |
| Rritja e parasë | | |
| Zvogëlimi i parasë | | |
| Paratë neto nga aktivitetet financuese | - | - |
| Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit | (1,773,023) | 1,864,518 |
| Paraja në fillim të vitit | 2,818,598 | 954,080 |
| Paraja në fund të vitit | 1,045,575 | 2,818,598 |

Çështja e cila ka rezultuar prej ekzaminimeve tona lidhur me këtë pasqyrë, është prezantuar në bazën për opinion.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre. Çështjet të cilat i kemi ngritur si rezultat i ekzaminimeve tona për këtë fushë, i kemi prezantuar në bazën për opinion.

4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Postës së Kosovës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe menaxhimin e rrezikut. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si operimi i një sistemi efektiv të auditimit të brendshëm dhe vendosja e politikave të qarta të kontabilitetit, kanë nevojë për përmirësim.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Kompanisë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit. NJAB kishte përgatitur planin vjetor ku kishte planifikuar nëntë auditime dhe tri aktivitete. Prej tyre tetë janë realizuar gjatë vitit 2018.

Përmes raporteve të saj, NJAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollet e brendshme dhe funksionimi i tyre. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në ngjarjet të kompanisë. Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha raportet e NJAB.

Çështja A14 - Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime dhe mos realizimi i planit të auditimit

E gjetura Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB-së janë cilësore dhe janë dhënë rekomandime konkrete për përmirësim të mëtutjeshëm. Megjithatë, auditimet e finalizuara nuk kishin mbuluar aktivitetet e vitit aktual, por në përgjithësi ishin fokusuar në aktivitetet e vitit 2017. Për më tej, njësi e auditimit të brendshëm ka realizuar shumicën e auditimeve të cilat i kishte planifikuar, mirëpo kjo njësi nuk ka realizuar planin në tërësi.

Rreziku Mos mbulueshmëria e periudhës aktuale me auditime nga NjAB zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Gjithashtu, një program i papërfunduar i NjAB-së zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrolleve në ndërmarrje. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare për Postën e Kosovës.

Rekomandimi A14 Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, në vitet e ardhshme përbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së duhet të monitorohet nga Komiteti i Auditimit dhe të ndërmerren veprime, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar që sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja A15 - Menaxhimi i rrezikut

Gjetja Sipas Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike par.15.9 si dhe parimit nr. 5 të standardeve të “Qeverisjes së Mirë” në mesin e detyrave dhe përgjegjësive të Bordit është vendosja e politikave për menaxhimin e rrezikut dhe kontrollin nëpërmjet indikatorëve të rrezikut të biznesit.

Ndërmarrja ende nuk ka politika të hartuara për vlerësim, identifikim dhe përcaktim të rreziqeve nëpërmjet regjistrit të rreziqeve sipas prioritetit apo llojit të paraparë. Po ashtu, mungon Politika për Menaxhimin e rrezikut, që do t'i mbulonte aktivitetet e përfshira në planifikimin, monitorim dhe kontroll të veprimeve që do të adresojnë problemet dhe dobësitë e identifikuara në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e Ndërmarrjes në arritjen e objektivave të saj. Në Planin e Biznesit (2017-2019) janë listuar disa rreziqe pa i dhënë gjasat e ndodhjes dhe ndikimin e tyre, pa një prioritet të tyre sipas kategorisë dhe klasifikimit si dhe nuk ka matje të rreziqeve për kundërveprime të qarta. E tërë kjo, si rezultat i vëmendjes së pamjaftueshme të Bordit të Drejtorëve në ndryshimet e ambientit të jashtëm apo të brendshëm ku është vërejtur që çështjet që kanë të bëjnë me rreziqet i diskuton në takimet e tyre të rregullta, por nuk i integron në proceset vendimmarrëse.

Rreziku Si rezultat i mungesës së një menaxhimi të rrezikut nëpërmjet indikatorëve të rrezikut biznesor (si: indikatorë financiar, etikë, ligjor, operacional, strategjik apo të tregut) ndërmarrja mund të mos jetë në dijeni për veprimet si përgjigje ndaj rrezikut. Kjo mund të shpie deri te dështimi i realizimit të objektivave, siç është rritja e vlerës së pasurisë dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Po ashtu, mungesa e një regjistri të rreziqeve potenciale, ndikon në pamundësinë e ndërmarrjes për të reaguuar me kohë apo për t'i reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme.

Rekomandimi A15 Kryesuesi i Bordit duhet të hartoj një politikë për menaxhimin e rrezikut dhe ta rishikoj atë në baza të rregullta kohore. Po ashtu, të hartoj një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre.

Çështja B1 - Mungesa e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël

Gjetja Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet” Një njësi ekonomike zgjedh dhe zbaton politikat e tij kontabël me qëndrueshmëri për transaksione, ngjarje dhe kushte të tjera të ngjashme. Sipas këtij standardi politikat kontabël janë parimet, bazat, marrëveshjet, rregullat dhe praktikat e veçanta që zbatohen nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Ato përfshijnë gjykime të bazuara në informacionet më të fundit, të besueshme dhe të disponueshme.

Përkundër faktit se Ndërmarrja ka një numër të rregulloreve, sipas Ligjit për NP ende nuk ka politika të qarta të gjykimeve dhe vlerësimeve kontabël i cili mund të përfshijë disa fusha të rëndësishme kontabël si: borxhet e këqija; humbja e vlerës së inventarit; vlera e drejtë e pasurive financiare/jo financiare apo detyrimeve financiare; jeta e dobishme e pasurive jo financiare ose modeli i pritshëm i konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në pasuri; dhe detyrimet e garancisë si dhe metodat e përlllogaritjes së amortizimit dhe zhvlerësimit. Kjo çështje ishte ngritur dhe rekomanduar edhe në vitin e kaluar. Kjo si pasojë e vëmendjes së pamjaftueshme të Bordit të Drejtorëve për çështje të cilat mund të rrezikojnë objektivat strategjike të Ndërmarrjes.

Rreziku Në mungesë të këtyre politikave të vlerësimeve mund të cenohet pjesa thelbësore e përgatitjes së PF dhe keq deklarimit të zërave material.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Bordit të merr vendim për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël dhe t'i rishikoj ato për ndryshimet e nevojshme.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit (Letër Menaxhmenti) për PFV-të të vitit 2017 të NP Posta e Kosovës ka rezultuar me 5 rekomandime kryesore. PK, kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Prej rekomandimeve të dhëna, një rekomandim është zbatuar plotësisht, tri (3) nuk janë zbatuar përderisa një është zbatuar pjesërisht. Për një përkrahje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2017 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|-----------------------------------|---|--|--|
| 1 | Politikat dhe procedurat Kontabël | Çështja: Politikat dhe procedurat Kontabël Rekomandojmë menaxhmentin të hartoj politika të përshtatshme kontabël në harmoni me standarde, ligje dhe rregullore në fuqi si dhe kërkesave profesionale të menaxhmentit. | Sipas zyrtarëve përgjegjës në PK, Në pamundësi financiare, kompania nuk ka qenë në gjendje të angazhojë kompani profesionale për hartimin e kësaj rregullore. Në këtë vit apo në vitin 2019, PK do të angazhojë kompani profesionale për hartimin e kësaj politike, qellim lehtësimin e punës së vartësve. | Rekomandim i pa zbatuar Ref. rekomandimi B2 |
| 2 | Menaxhimi i Pasurive | Çështja: Prona, Impijantet dhe Pajisjet Ne rekomandojmë menaxhmentit të kompanisë, duke analizuar kosotot e një veprimi të tillë të bëjë rivlerësimin e asetëve me qellim të prezantimit të vlerës reale të tyre. Po ashtu statuti i pronësisë së pronës duhet të jetë temë e angazhimeve të mëtejme të menaxhmentit të kompanisë. Rekomandojmë menaxhmentit të kompanisë të mbaj evidencë të mjaftueshme të duhur lidhur me testin e dëmeve të asetëve të saj. | Sipas zyrtarëve përgjegjës të PK, Në momentin e përshtatshmërisë financiare, PK do të angazhojë kompani profesionale për rivlerësimin e të gjitha asetëve të PK. Drejtoria ligjore ka drejtuar kërkesat zyrtare për bartjen e pronësisë në emër të PK-së dhe ky proces është në zhvillim e sipër | Rekomandim i pa zbatuar Ref, rekomandimi B1 |
| 3 | Librat e blerjeve dhe shitjeve | Çështja: Librat e blerjeve dhe shitjeve | Departamenti i teknologjisë së Informacionit dhe i sistemit të informacionit – DTISI, në mungesë të zhvilluesit të aplikacioneve | Rekomandim i pa zbatuar, mirëpo |

| | | | | |
|---|--|---|---|---|
| | | <p>Rekomandojmë menaxhmentin e kompanisë që të bëjë përpjekje të integroj dhe të përfshij librat e blerjeve dhe shitjeve në programin kontabël ERP në formatin elektronik dhe automatik sipas kërkesave ligjore dhe profesionale. Programet e aplikueshme kontabël një mundësi të tillë ofrojnë me përpjekje dhe angazhim të resurseve.</p> | <p>është përpjekur që përmes administratorit të bazës së të dhënave t`ju ofrojmë një zgjedhje për realizimin e librave të shitjes dhe librave të blerjes nga aplikacioni i ERP, mirëpo nuk kemi arritur që ta automatizojmë konform kërkesave të ATK. Këtë mund ta realizojmë vetëm përmes zhvilluesit të aplikacioneve që në departamentin tonë nuk e kemi për momentin.</p> | <p>Për shkak të rëndësisë e vlerësojmë si Rekomandim i mbyllur.</p> |
| 4 | <p>Pozicionet e hapura të llogarive të caktuara në fund të periudhës</p> | <p>Çështja: Pozicionet e hapura të llogarive të caktuara në fund të periudhës Rekomandojmë menaxhmentin që në afate të caktuara ligjore periodike të aplikoj “letërkujtesat”, dhe letrat e “extraktit të pozicionit të hapur” lidhur me pozitat e hapura të klientëve të kompanisë. Të njëjtin veprim ta bëjë edhe me rastin e marrjes së letrave të tilla nga furnitorët duke u përgjigjur në letrat e pranuar.</p> | <p>Rekomandimi është zbatuar Ref. B8.5</p> | <p>Rekomandim i zbatuar</p> |
| 5 | <p>Borxhet e këqija dhe shpenzimet kontingjente</p> | <p>Çështja: Borxhet e këqija dhe shpenzimet kontingjente Ne rekomandojmë që kompania të trajtoj borxhet e këqija sipas ligjeve, standardeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë.</p> | <p>Si rezultat i analizimit të këtij rekomandimi dhe marrjes së dëshmive shtesë lidhur me implementimin e tij, kemi vërejtur që pjesa e parë e kësaj të gjeture (e cila ka të bëjë me borxhet e këqija) është implementuar këtë vit ref B4.6_2 Borgjet e këqija. Ndërsa, në çështjen e ngritur për shpenzimet kontingjente edhe pse kishte progres ku shpenzimet për gjoba dhe ndëshkime nuk janë prezantuar në këtë kategori. Këtë vit janë prezantuar shpenzime tjerë të cilat po ashtu nuk i takojnë kësaj kategorie të shpenzimeve, siç janë funksionalizimi dhe mirëmbajtje pajisjeve,</p> | <p>Rekomandim i Zbatuar pjesërisht Ref. C1_Rekomandimi në këtë raport</p> |

| | | | | |
|---|-------------------|---|---|--|
| | | | shpenzime të qirasë, transportit dhe disa shpenzime tjera. Ref. B4.6_1, B4.6_3, B4.6_3.1, B4.6_3.2, B4.6_3.3, B4.6_3.4, B4.6_3.5 dhe B4.6_3.6 dëshmitë. Sipas zyrtarëve përgjegjës në PK, si rezultat i mos planifikimit të këtyre shpenzimeve janë regjistruar dhe prezantuar në këtë kategori. | |
| | Fusha e auditimit | Rekomandimet e vitit 2018 | | |
| 1 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të merr vendim për ndërmarrjen e procedurës për vlerësim të pasurive e cila është e domosdoshme për paraqitjen e vlerave reale të pasurive në pasqyra financiare dhe eliminimi i mundësisë së nënvlerësimit të tyre sidomos i vlerës së ndërtesave. | | |
| 2 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura duke trajtuar pronat e uzurpuara në regjistra të veçantë të pasurive dhe trajtimet e duhura kontabël duke përfshi shpalosjet e nevojshme/mjaftueshme në pasqyra financiare si dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime ligjore që të krijoj qasje në të gjitha pronat e Postës së Kosovës. | | |
| 3 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se po praktikohen regjistrimet kontabël që të transferojnë shumat ndërmjet të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve për një klient/furnitor të caktuar të postës ndërkombëtare. Përveç kësaj, të bëhen korrigjimet për të reflektuar ngjarje të korrigjueshme pas periudhës së raportimit deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare, ndërsa të bëhen shpalosjet e duhura duke dhënë shënime shpjeguese që pasqyrat financiare nuk reflektojnë ngjarje pas datës së publikimit. | | |
| 4 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë që janë marrë veprimet korrigjuese për zërat kontabël të arkëtueshmet, stoqet, kërkesat tjera dhe të pagueshmet, të hyrat e shtyra për të siguruar gjendje dhe prezantim të saktë të tyre në pasqyrat financiare. | | |
| 5 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël të jenë të jenë harmonizuar me gjendjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore për TVSH, tatimin mbi pagat dhe kontributet e pensioneve | | |
| 6 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë marrë veprime korrigjuese në mënyrë që të hyrat të njihen saktë duke përfshirë zbritjet tregtare, si dhe të hyrat nga grantet të njihen në periudhën e duhur kontabël kontabël. | | |

| | | |
|----|--|--|
| 7 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarr masat e duhura ashtu që të vendosen kontrollet adekuate të cilat mundësojnë zbatim adekuat të kontratave përmes të cilave ndërmarrja zhvillon aktivitetet afariste. |
| 8 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek rrjedha e parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre. |
| 9 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit të sigurojë që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit. |
| 10 | Baza për Opinion | Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në modifikimin e opinionit. Po ashtu, të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre. Përveç kësaj, Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD. |
| 11 | Pasqyra e pozitës financiare | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura/ligjore në mënyrë që të qartësohet statusi i pronave dhe të zgjidhen kontestet ligjore lidhur me këto pasuri. |
| 12 | Pasqyra e pozitës financiare | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se në mënyrë sistematike behën harmonizimet e shënimeve kontabël me faturat e furnitorëve dhe pagesat e bëra dhe të prezantoj gjendjen e saktë të llogarive të pagueshme tregtare për secilën periudhë. |
| 13 | Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve | Kryesuesi i Bordit të sigurojë hartimin e rregulloreve në fushën e të hyrave duke përcaktuar procedura dhe përgjegjësitë të qarta për menaxhimin e secilit lloj të të hyrave. |
| 14 | Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve | Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për t'i eliminuar gabimet në regjistrimet dhe prezantimin e shpenzimeve duke siguruar raportim të drejtë të tyre. |

| | | |
|----|---------------------|---|
| 15 | Auditimi Brendshëm | Kryesuesi i Bordit në bashkëpunim më Komitetin e Auditimit, duhet të rishikojnë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në proceset e vitit aktual dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, në vitet e ardhshme përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së duhet të monitorohet nga Komiteti i Auditimit çdo dy muaj dhe të ndërmer veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur |
| 16 | Menaxhim i Rrezikut | Kryesuesi i Bordit duhet që të hartoj një politikë të menaxhimit të rrezikut dhe të rishikoj në baza të rregullta kohore. Si dhe të hartoj një plan i cili do të identifikoj të gjitha rreziqet e mundshme, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato të mëvonshme si përgjigje ndaj tyre. |
| 17 | Politikat Kontabël | Kryesuesi i Bordit të merr vendim për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël dhe t'i rishikoj ato për ndryshime e nevojshme. |

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.

PK, SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-1326/2019
Data/Date/Batum 21-06-19
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Posta e Kosovës sh.a, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dërgojmë të plotësuar pyetësorin për vlerësimin e subjektit të auditimit. Këtë pyetësor do të pranoni me letër përcjellëse të raportit final të auditimit.

Z. Halit Isufi

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Data: 21. qershor.2019, Prishtinë,

